



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1115/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevci anëtarë duke vendosur përkitazi me apelet e Kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit, Lendita Krasniqi, të dyja nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 15.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHEN të pasafatshme apelet A.nr.1115/2021 dhe A.nr.1116/2021 të paraqitura nga Lendita Krasniqi kandidate për antare të Kuvendit komunal në Komunën e obiliqit nga Subjekti Politik Levizja Vetvendosje me seli në Prishtinë-Dega në Obiliq, A.nr. 1115/2021 dhe Anr.1116/2021. Të dy apelet të paraqitura nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Obiliqit nga radhët e Subjektit politik Levizja Vetvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e obiliqit.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 12.11.2021, ka pranuar apelet A.nr.1115/2021 dhe A.nr.1116/2021 i paraqitur nga Lendita Krasniqi kandidate për antare të Kuvendit komunal në komunën e Obiliqit nga rradhët e Subjektit Politik Levizja Vetvendosje (LVV) më seli në Prishtinë-dega në komunën e Obiliqit, me të cilat ka kërkuar rinumërim të votave pasi që e njëjta dhe kundër- kandidatja e sajë kanë numra të barabart të votave me nga 27 vota, dhe thekson se ka dyshime të bazuara se mund të i jet shtuar ndonje votë kundër-kandidates, pasi që në atë vendvotim është bërë shumë presjon , po ashtu ka theksuar se në atë vendvotim është e sigurt se ka pasur të pakten një (1) votë , dhe se në atë vendvotim votojn familjart dhe rrethi i gjerë i familjes me mbiemër Krasniqi e njëjta ka dyshime që ju kanë keqpërdorur (vjedhur) votat.

Paneli, pas shqyrtimit të afatshmëris së apeleve, gjeti se:

Apelet janë te pasafatshme,

Paneli duke vepruar konform Rregullës Nr. 02/2015 Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, përkatësisht në bazë të nenit 13.2 “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të apeleve, kryesuesi i panelit vendim marrës mund të vendosë ta bëjë bashkimin e apeleve që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim” ka bashkuar apelet A.nr.1115/2021,dhe A.nr. 1116/2021, dhe janë proceduar si një lënd e përbashkët të udhëhequra me numrin A.nr.1115/2021.

Paneli, vlerëson së në këtë fazë të procesit zgjedhor kur janë dorëzuar apelet në PZAP, me pretendime nga ankuesja, që të urdhërohet KQZ-ja, që të bëjë rinumërimin e votave në Vendvotimet e theksuara në apele, nuk mund të procedohen si apele të afatshme, sepse për pakënaqësitë dhe parregullsitë eventuale, lidhur me rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve lokale 2021, afati për të paraqitur ankesa në PZAP, ka qenë deri me datë 04.11.2021, në ora 16:00, sepse KQZ-ja e ka shpallë rezultatin e këtyre zgjedhjeve me datë 04.11.2021, dhe afati për ankesa ka qenë 24 orë, nga koha e shpalljes së këtyre rezultateve ndërsa apelet në PZAP, nga ankuesja, janë paraqitur pas afatit të lartçekur respektivisht me datë 12.11.2021, prandaj paneli nuk është lëshuar mëtej në çështje meritorë për rastet e vendosura, në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuara më lart, e në kuptim të nenit 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.1115/.2021 më datë 15.11.2021

Kryesuesi i Panelit
Milena Đerić



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi, në Gjykatën Supreme të Kosovës.